



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.569/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Mejhone Mataj me vendbanim në Austri, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

### **V E N D I M**

**HUDHET** i palejuar apeli Anr.569/2021 i paraqitur nga Mejhone Mataj me vendbanim në Austri, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

### **A r s y e t i m**

Me datën 31.08.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Mejhone Mataj me vendbanim në Austri në të cilin pretendon se KQZ, nuk e ka përfshirë në listat e votuesve jashtë vendit edhe pse e njëjta e ka pranuar konfirmimin nga KQZ se është në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës.

Parashtruesi i apelit, apelit i ka bashkangjitur emailin nga KQZ, formularin e aplikimit për Mejhone Mataj dhe dokumentin identifikues/ letërnjoftimin.

Me datë 31.08.2021 PZAP, ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur me apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 01.09.2021 në ora 09:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se Mejhone Mataj, me numër të regjistrimit të KQZ-së 2021171023751, është votuese në listën e votuesve jashtë Kosovës. Emri i saj figuron në faqen numër 646 të Listës së Votuesve jashtë Kosovës, që është e publikuar në ueb faqen e KQZ-së

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Parashtrueses së Apelit i mungon interesi juridik**

Me datë 31.08.2021 Mejhone Mataj ka parashtruar në PZAP apel ndaj KQZ-së, për mos përfshirje në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021.

PZAP ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ palët e interesuar mund të parashtrojnë Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtruesit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.

KQZ-ja me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtruesi i apelit gjendet në listën e votuesve meqenëse i njëjti, i plotëson kushtet për tu përfshirë në listë.

Për arsyet e lartcekura, paneli erdhi në përfundim se në rastin konkret parashtrueses së apelit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse e njëjta veç është e përfshirë në listën e votuesve, si votues jashtë vendit dhe emri i saj figuron në faqen me numër 646 të Listës së Votuesve jashtë Kosovës, që është e publikuar në ueb faqen e KQZ-së.

Prandaj paneli, nga arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.569/2021 më datën 02.09.2021

**Kryesuesi i Panelit**

Adnan Konushaj



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.